



Ndal Punës së Fëmijëve

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve
nëpërmjet edukimit,
artit dhe medias

Figura

Objektivi: Të realizohet figura e fëmijës që punon. T'i japësh shpirt kësaj figure. Të përcaktosh në një këndvështrim më të gjerë dhe global të mjedisit ku jeton fëmija që punon.



Përfundimi: Pjesëmarrësit të përfshihen emocionalisht në realizimin e figurës së fëmijës që punon, dhe në trajtimin e këtij problemi. Të komunikojnë ndjenjën e përgjegjësisë për figurën e vajzës apo të djalit që punon. Të fillojnë të mendojnë si mund të realizohen disa ndryshime në shoqëri.

Koha

4 orë mësimi më vete ose dy sesione me nga 2 orë mësimi.

Motivimi

Nëse këni realizuar modulën e dytë, "Kolazhi", grupi ka kuptuar sa thjesht shoqëria nuk e shikon punën e fëmijëve ose nuk e vlerëson fare atë. Pra, grupi e ka të qartë sa nevojtarë janë fëmijët që punojnë. Puna e fëmijëve ekziston, por ne dimë pak, pasi media ose nuk flet fare, ose flet fare pak për të. Pra, si mund të pasqyrohet puna e fëmijëve. Ky modul synon të tregojë "fytyrën" e kësaj dukurie.

Objektivi i veprimtarisë së parë të këtij moduli është të ndihmojë krijimin e një tabloje të punës së fëmijëve. Ndoshta, në mjedisin tuaj, ka raste të punës së



Shënim për përdoruesin

Nëse dëshironi të zhvilloni me rregull të gjitha modulet e programit, ju këshillojmë që ky modul të zhvillohet pas modulit të kolazhit. Meqë të dyja modulet përdorin figurat dhe pamjet për të përcjell mesazhin, ato plotësojnë njëri-tjetrin. Mirë është që grupi të jetë njohur me të dhëna statistikore bazë për punën e fëmijëve (moduli për informacionin bazë) dhe të jetë realizuar një veprimtari sensibilizuese e grupit.



fëmijëve dhe pikërisht këto raste ju duhet t'ia bëni të njohur grupit. Ndoshta, pjesëtarë të grupit kanë përvoja vetjake të punës ose i njohin fëmijë që punojnë. Bëjini që ata të tregojnë për këto përvoja. Ka edhe vende ku puna e fëmijëve nuk ndeshet, prandaj është e nevojshme të krijohet figura e vertetë e fëmijës që punon, në mënyrë që grupi të kuptojë dhe të ndjejë thellë jetën e tij.

Ky modul do t'i bëjë pjesëtarët e grupit të projekti SCREAM (Ndal punës së fëmijëve), të mendojnë dhe të mbajnë qëndrim të thellë për punën e fëmijëve duke i vënë edhe në provë. Qëllimi është të zhvillojë njohjen dhe kuptimin e punës së fëmijëve nga afër.

Veprimtaria që do të realizojnë, do të prekë emocionalisht grupin, madje, do të zgjojë një ndjenjë zëmërimi. Në përfundim të veprimtarisë, grupi do të përjetojë një sërë emocionesh.

Veprimtaria e dytë përbën një hap tjetër përpara. Ajo trajton gjerësisht jetën dhe punën e fëmijës, si dhe fillon të përshkruajë historinë dhe të ardhmen e tij. Dhe, së fundi, analizon problemin tepër të vështirë, ndryshimin e gjendjes së këtyre fëmijëve, që duhet të realizohet.

Disa nga të rinjtë e grupit tuaj, në kuadër të veprimtarisë së OJF-eve të ndryshme, mund të punojnë vullnetarisht në ndihmë të njerëzve me probleme, të moshuarve, fëmijëve etj. Këto shtresa të shoqërisë kanë të njëjtat probleme, pasi janë shtresa të lëna pasdore madje dhe të dhunuara. Por, e gjithë kjo përforcon tek këta të rinjtë idenë se çdo individ në shoqëri duhet të luajë një rol të caktuar për të ndryshuar gjendjen.

Në këtë modul jepet edhe teknika e rrahjes së mendimeve (brainstormingu), një metodë shumë e vlefshme që u jep mundësi të gjithë pjesëmarrësve të shprehin lirshëm emocionet, mendimet dhe idetë e tyre. Ajo është një metodë që mundëson dhe nxit shprehjen e atyre emocioneve që normalisht mund të mbeten të fshehura. Nga ana tjetër, ndihmon të rrënjoset në ndërgjegjen e fëmijëve ideja e domosdoshmërisë së pjesëmarrjes së tyre në procesin e mënjanimit dhe të ndalimit të punës së fëmijëve.

Ç'mjete duhen:

- ✓ Një fotografi ose një pamje gazete që tregon një fëmijë që punon;
- ✓ Një mjedis ku të mblidhet grupi, një dhomë ose një klasë. Nëse grupi është i madh, ndaheni në nëngrupe më të vogla dhe po kështu ndaheni mjedisin e klasës në kënde pune;
- ✓ Një mur ku të varni posterin apo fotografinë e fëmijës që punon;
- ✓ Letra, lapsa dhe stilolapsa, për grupin;
- ✓ Nëse keni mundësi, një dërrasë të zezë ose një tabak letre të vendosura në një mbajtëse.



Përgatitja

Për përgatitjen e veprimtarisë, zgjidhni një ose dy fotografi që tregojnë fëmijë që punojnë. Nëse nuk keni fotokopjues, mos u shqetësoni, edhe këto dy fotografi mund ta kryejnë mirë misionin e tyre (për këtë modul mund të shërbejnë edhe fotografitë që i bashkangjiten këtij grupi modulesh).

Në të kundërtën, mund të kërkonte figura të tjera në një nga burimet e mëposhtme:

- Nëse keni mundësi në internet drejtojeni në faqen web IPEC (www.ilo.org/public/english/standards/ipecc/index.htm), i cili përmban një arkiv me fotografi të fëmijëve që punojnë. Gjeni një fotografi që është e përshtatshme për ju, dhe printojeni në aq kopje sa ju duhen. Nëse keni një printer me ngjyra, kjo do të ishte më mirë, por dhe bardhë e zi është e mjaftueshme.
- ILO, gjithashtu, ka postera për punën e fëmijëve që mund të jenë të dobishëm.





Shënim për përdoruesin

IPEC ka një version të katalogut në cd-rom, që lidhet me kopertinën e modulit "Deklarata", "Konventa Ndërkombëtare" dhe fotografi të punës së fëmijëve, që mund t'i kërkohen drejtpërdrejt IPEC-ut. Për të porositur këto materiale, drejtojuni pikës së takimit që IPEC-u ju jepet në këtë paketë



- Në faqet web të organizatave të tjera, si: UNICEF, UNESCO etj., mund të gjeni materiale të dobishme.

Përzgjedhja e figurave të bëhet mbi bazën e treguesve të mëposhtëm:

- Analizoni përbërjen e grupit tuaj nga pikëpamja e moshës, seksit dhe mjedisit socialkulturore nga i cili vjen. Kjo do t'ju ndihmojë të zgjidhni ato fotografi që mund të jenë më prekëse për grupin tuaj. Kështu, p.sh., duhet të mendoni nëse është më mirë të zgjidhni një figurë djali apo një vajze që punon. Cili duhet të jetë mjedisi i punës, në Afrikë, Azi, Amerikë Latine apo në Evropë. Nëse është e mundur, përzgjidhni figura që përfaqësojnë shfrytëzimin më të egër të punës së fëmijëve. Pra, mund të përzgjedhni figura të ndryshme dhe t'i përdorni në situata të ndryshme.
- Zgjidhni fotografi që janë të një cilësie të mirë dhe që janë të pasura me detaje. Kjo do t'ju ndihmojë pjesëtarët e grupit të krijojnë një përfytyrim vetjak e të saktë për fëmijën që punon, nga vjen, ç'bën, si jeton etj. Kjo është një kërkesë shumë e rëndësishme e veprimtarisë.
- Sigurohuni që të gjithë në grup të jenë të pajisur me lapsa dhe letër në mënyrë që të shprehin atë që dëshirojnë gjatë veprimtarisë. Nëse është e mundur, siguroni një dërrasë të zezë ose tabak letre, të cilat do t'ju ndihmojnë shumë gjatë diskutimit të përgjithshëm.
- Nëse hasni vështirësi në gjetjen e materialeve, ftojini pjesëtarët e grupit të ndihmojnë në gjetjen e fotografive. Përfshirja e grupit në gjetjen e materialeve do të forcojë ndjenjën e krijimit të grupit, do të motivojë interesin për të bashkëpunuar si anëtar i këtij grupi. Në këtë mënyrë, do të nxisni kuriozitetin e natyrshëm të të rinjve, të cilët do të pyesin pse duhet i gjithë ky material.

Zhvillimi i modulit

Pjesa e parë e veprimtarisë realizon profilin e një fëmije që punon mbi bazën e një fotografie ose posterit. Fotografia është pikënisja e punës së grupit që kërkon të përdoret imagjinata dhe krijimtaria. Pasi të kenë krijuar një profil të fëmijës që punon, secili grup, do të bëjë paraqitjen e gjetjeve. Më pas do të fillojë seanca e pyetjeve dhe diskutimeve ndërmjet nëngrupeve.

Kjo veprimtari mund të realizohet në dy mënyra. Së pari, mund të përdoret vetëm një fotografi për të gjitha grupet, të cilat do të diskutojnë për profilin e fëmijës që kanë krijuar.

Së dyti, secilit grup i jepni fotografi të ndryshme që të rrisni shkallën e të menduarit ndryshe dhe të përforconi konceptin se puna e fëmijëve shfaqet në forma të ndryshme. Kjo zgjedhje bëhet nga ju duke u nisur nga njohja që keni për përbërjen e grupit.

Në varësi të numrit të pjesëtarëve të grupit, punohet me një grup ose me disa nëngrupe me 4-5 veta secili. Të rinjtë, po të përpiqen të vetëm të krijojnë profilin e fëmijës që punon, mund të hasin vështirësi, ndërsa duke punuar në grupe me 2-5 veta, do të ndjehen më mirë.



Fotografi

*Organizimi
i grupit*



Veprimtaria 1. Krijimi i profilit të fëmijës që punon

1 orë mësimi ose dy orë mësimi të veçanta.

Secili pjesëtar i grupit duhet të familjarizohet me figurën që keni zgjedhur. Nëse nuk keni kopje të mjaftueshme, kalojeni ekzemplarin në duart e secilit pjesëtar të grupit dhe pasi të shihet me kujdes, vareni në mur në mënyrë që të jetë e dukshme gjatë gjithë kohës së zhvillimit të veprimtarisë. Nëse keni një fotografi për grup, pasi fotografia të ketë qarkulluar në duart e të gjithëve, vendoseni në qendër, në mënyrë që ta shohin të gjithë.

Kaloni nga një grup tek tjetri dhe ftojini të rinjtë të vëzhgojnë me vëmendje fotografinë dhe të mendojnë rreth fëmijës, duke i dhënë liri të plotë imagjinatës së tyre.

Kjo pjesë e veprimtarisë ka dy faza.

Në fazën e parë, grupi duhet të mbajë qëndrim rreth identitetit të fëmijës, mjedisit ku jeton dhe punon. Grupi duhet të bëjë disa pyetje. Paraprakisht ju mund të keni përgatitur një listë me pyetje, të cilat i fotokopjoni dhe i shpërndani ose dhe i lexoni, por e rëndësishme është të mos i shkruani të gjitha pyetjet në mënyrë që ato të dalin nga vetë grupi. Po t'u paraqitej një listë me pothuajse të gjitha pyetjet, kjo do të ulte motivimin e tyre për të bërë pyetje të tjera.

Orientoni grupin të përvijojë profilin e fëmijës që punon, sipas pyetjeve të mëposhtme:

- Bëhet fjalë për një vajzë apo për një djalë?
- Sa vjeç mund të jetë?
- Nga ç'vend është?
- Pse është i veshur në këtë mënyrë apo pse mban këtë vegël?
- Në ç'moment të ditës është?
- Në ç'vend pune është fëmija?
- Është në një zonë rurale apo urbane?

Burime të mundshme



Grupet mund të paraqesin profilin e fëmijës nëpërmjet një tregimi, nëpërmjet shënimeve apo thjesht duke dhënë ide. Të tjerë, mund ta paraqesin nëpërmjet një situatë që kanë në mendje, si dhe të japin një tablo të detajuar të punës që bën fëmija. Nuk është e rëndësishme si ata e paraqesin, të gjitha janë të mirëpritura. Gjatë gjithë kohës që zgjat veprimtaria, ju duhet të flisni për të mbajtur gjall interesin e pjesëmarrësve.

Pasi të rinjtë e grupit janë përpjekur t'u përgjigjen të gjitha pyetjeve dhe ju jeni të kënaqur nga përgjigjet e tyre, kaloni në një seri tjetër pyetjesh, më vetjake, duke e trajtuar më në thellësi problemin.

- Si quhet fëmija?
- Sa kohë ka që punon?
- A ka prindër, vëllezër dhe motra, po kafshë?
- Cili është pozicioni ekonomik dhe shoqëror i fëmijës?
- Pse punon?
- Në punën që bënë, a është i rëndësishëm seksi i fëmijës?
- Në vendin e punës, fëmija dhunohet, rrihet, abuzohet seksualisht ose në të kundërtën trajtohet mirë?
- Kush janë miqtë dhe armiqtë e fëmijës në vendin e punës apo në mjedise të tjera?
- Çfarë do të parapëlqente ky fëmijë të bënte në vend që të punonte?
- A ka diçka të tijën ky fëmijë dhe nëse ka, si e ka siguruar?
- Cilat janë kujtimet më të bukura ose më të këqija të fëmijës?

Në këtë fazë, nga pjesëtarët kërkohet të përdorin imagjinatën dhe krijimtarinë e tyre. Fillimisht, të rinjtë mund të ngurojnë të përgjigjen duke thënë: "Nga ta dimë ne si quhet? Ndoshta këta fëmijë flasin një gjuhë tjetër? Si mund të dimë se me çfarë lodrash luajnë apo çfarë lojëra pëlqejnë?". Pikërisht, ky është çasti më i rëndësishëm i veprimtarisë. Pjesëmarrësit njohin vetëm anën e jashtme të fëmijës. Por janë pikërisht ata që duhet t'i japin trup dhe shpirt këtij fëmije, i cili duhet të ketë jetën e tij, një të kaluar dhe një familje. Pas një farë ngurimi dhe vështirësie,

Krijimi i profilit



të gjithë do të marrin pjesë në krijimin e figurës së plotë të fëmijës, madje në mënyrë shumë krijuese.

Ky është përfundimi që duhet të arrini. Zhvendosuni nga një grup në tjetrin dhe shikoni si punojnë. Dëgjojini diskutimet, ndërhyri dhe nxitini të bëjnë shaka. Thuajuni që portretizimi i fëmijës punëtor mund të bëhet në forma të ndryshme dhe për këtë ata duhet të jenë krijues dhe me fantazi, madje edhe kur e paraqesin para të tjerëve. Paraqitja mund të bëhet me fjalë, me figura etj. Për këtë mund të përdoret dërrasa e zezë ose tabakët e letrave.

Respektoni kohën që ju keni caktuar (rreth 20 minuta). Grupi duhet të punojë me ritëm. Në përfundim të kohës së caktuar, mblidhuni të gjithë bashkë për diskutimin përfundimtar.

Paraqitja e profilit

Të gjithë pjesëtarët e grupeve kanë dëshirë të flasin për figurën e krijuar nga vetë ata. Jepuni mundësi që të gjitha grupet të paraqesin portretin e fëmijës që punon, të cilën e kanë krijuar vetë dhe të diskutojnë ndërmjet tyre.

Nëse paraqitja e njërit prej grupeve është origjinale, jepini kohën që kërkojnë, për ta paraqitur sa më mirë. Kur ka një tip të till paraqitjeje (që ndodh rrallë), bashkëveprimi ndërmjet pjesëtarëve të grupit dhe të tjerëve është shumë i gjallë dhe nxitës. Jepini hapësirën e duhur paraqitjes, pa e dëmtuar.



Nëse vlerësoni si të dobishme përdorimin e elementeve të garës, mund t'i përdorni, si, p.sh.:

- Jepni një çmim për portretizimin më të detajuar dhe të arrirë. Një grup mund të luajë rolin e jurisë.
- Jepni një çmim për paraqitjen më origjinale.

Në dërrasën e zezë ose në fletët e tabakut shënoni karakteristikat e secilit personazh.

Nëse të gjitha grupet kanë punuar me të njëjtën fotografi, në seancën plenare mundohuni të portretizoni fëmijën që punon, duke përdorur disa nga karakteristikat që kanë dalë nga secili grup. Nënvizoni faktin se të gjithë kanë marrë pjesë në krijimin e kësaj figure. Tashmë ky personazh merr frymë, flet, ndjen, qan dhe qesh.

Ky është një çast shumë i rëndësishëm që ndikon në sensibilizimin e të rinjve. Tashmë ata e kanë më të thjeshtë të lidhen me figurën e fëmijës që punon, pasi ai është një fëmijë si ata. Tashmë ky personazh është një mik i grupit, është dikush për të cilin kanë ndjenja të caktuara. Vetëm në këtë mënyrë ata mund të kuptojnë dhimbjen, privimin, poshtërimin që ky fëmijë provon çdo ditë. Ky është një proces i fortë sensibilizimi dhe njohjeje për të rinjtë. Që nga ky çast, asgjë nuk është si më parë.



Deri në përfundim të diskutimit, mbani një ritëm të lartë. Komunikoni në mënyrë të drejtpërdrejtë. Shikojini drejt e në sy gjatë paraqitjes që i bëjnë jetës së fëmijës. Jini sa më shprehës që të mundeni. Lëvizni nëpër klasë dhe shoqërojini edhe me gjeste vuajtjet e fëmijëve që punojnë. Ndoshta, emocionalisht mund të jetë dëshpëruese për të rinjtë, por kjo është pjesë e punës së fëmijëve. Ju nuk po përballeni me një dukuri të bukur të shoqërisë, përkundrazi ju po përballeni me diçka të keqe për fëmijët, madje që mund t'u shkaktojë atyre vdekjen. Është një dukuri që u shkatërron jetën dhe u heq një nga të drejtat themelore të njeriut, të drejtën për të qenë i lirë.

Veprimtaria 2. Përcaktimi i kushteve

1 orë mësimi



Fëmijët që punojnë, nuk jetojnë në një vend të izoluar. Ata nuk jetojnë në një ishull të shkretëtë, të varfër dhe të mjerë, të mbushur me dhimbje. Këta fëmijë jetojnë mes nesh. Në të njëjtin vend ose edhe më afër, pranë shtëpisë ku jetojmë. Është e rëndësishme që i gjithë grupi të ndërgjegjësohet dhe të kuptojë se nuk bëhet fjalë për një dukuri të papërcaktuar ose të trilluar. Tashmë ka ardhur koha të shpjegohen kushtet në të cilat zhvillohet puna e fëmijëve dhe kryesore këtu është mjedisi dhe shoqëria e përbashkët në një kuptim global.

Pasi të rinjtë janë njohur me punën e fëmijëve, ata duhet të ndiejnë zëmërimin e thellë për këtë gjendje, të kuptojnë nevojën për të ndryshuar gjërat dhe të kenë dëshirën për ta bërë këtë.

Ushtrimet e mëposhtme të rrahjes së mendimeve (brainstormingu) do të nxisin grupin të zhvillojë më tej imagjinatën për jetën e fëmijës që punon, që ka filluar qysh në pjesën e parë të këtij moduli. Kjo është një veprimtari e këndshme, nxitëse që mund të nxjerrë thënie të rëndësishme ose jo në lidhje me punën e fëmijëve. Në të gjitha situatat që do të krijohen, një gjë është e sigurtë, të gjithë të rinjtë e grupit do të bëhen mbështetës të ndryshimit.

Ç'është rrahja e mendimeve (brainstormingu)?

Brainstormingu është diskutimi i përqendruar i ideve dhe mendimeve për një çështje, duke u vlerësuar tërësisht në kuptimin intelektual. Sforcimi lidhet me kohën e kufizuar në dispozicion apo edhe me kufizime të tjera psikologjike a fizike. Stresi mendor dhe fizik që shoqëron këtë proces, i detyron pjesëmarrësit të japin përgjigje të drejtpërdrejta, ashtu siç i mendojnë. Në pjesën më të madhe të rasteve, ky ushtrim nxit reagime të sinqerta dhe emocionale.

Brainstormingu është një ushtrim intensiv. Siç kemi thënë më parë, mund të jetë shumë argëtues dhe në të njëjtën kohë i dobishëm dhe zbulues. Nëse nuk përgatitet dhe programohet ashtu siç duhet, mund të përfundojë në rrëmuje dhe të degjenerojë në kaos. Nëse fëmijët e kuptojnë që ju nuk e keni përgatitur realizimin e mirë të ushtrimit, do të humbin interesin për zhvillimin e tij. Strategjia që duhet të udhëheqë zhvillimin e brainstormingut qëndron në sigurimin e kontrollit të grupit, shkrimin në dërrasën e zezë të ideve dhe mendimeve me një ritëm të caktuar. Secili pjesëmarrës duhet të shprehet shpejtë dhe qartë, pa patur kohë të mendojë në thellësi problemin që diskutohet.



Sigurohuni që keni të njëjtët pjesëmarrës të veprimtarisë së parë. Jepuni të njëjtën figurë të fëmijës që punon.

Përcaktimi i detyrave

Në fillim të veprimtarisë, për 10 minuta, përsërisni karakteristikat e fëmijëve që punojnë, të cilat janë vënë në dukje në veprimtarinë e parë. Gjatë paraqitjes ka një rëndësi të madhe edukative përdorimi i emrave të fëmijëve që keni përdorur në veprimtarinë e parë. Kjo është e rëndësishme që ta bëni ju, pasi në këtë mënyrë do t'u përgjigjen edhe të rinjtë. Duke pranuar emrin dhe personalitetin e fëmijës që vetë të rinjtë kanë krijuar, ju ndihmon të ndërtoni një marrëdhënie besimi reciprok në grup.

Ndikimi i ndryshimit

Në këtë fazë, duhet të nxirrni në pah ato veprimtari të cilat mund të ndihmojnë në ndryshimin e gjendjes së fëmijëve që punojnë. Veçanërisht, duhet të përqendrohemi në ato fakte (në nivel lokal, rajonal, kombëtar ose ndërkombëtarë), të cilat, nëse ka të tilla, kanë patur ndikim në jetën e fëmijëve që punojnë.

Me këtë synim zhvilloni një seancë brainstormingu në mënyrë argëtuese. Qëllimi është të nxisni të rinjtë të mbajnë qëndrim rreth ndikimit që kanë ndryshimet në nivel ndërkombëtar në jetën e fëmijëve që punojnë, pavarësisht se këto ndryshime janë për mirë ose për keq.

Po kështu, tregojuni të rinjve se fotografia që kanë përpara, është bërë dy ose tre vjet më parë. Të rinjtë duhet të përmendin disa ndryshime që ka patur në nivel ndërkombëtar për punën e fëmijëve, si dhe të evidentojnë ndikimin e tyre ndaj fëmijës së fotografisë.

Këtë gjë mund ta bëni në dy mënyra:

- të rinjtë mund të shkruajnë në tabak letre të gjitha ngjarjet që kanë ndodhur në këtë kohë ose
- të gjithë të rinjtë mund të shprehin mendimet e tyre dhe njëri do të këtë detyrën t'i shkruajë në dërrasën e zezë.



Sqaroni pjesëmarrësit se këto ngjarje mund të jenë të natyrave të ndryshme: ngjarje sportive, luftë civile, grevë, manifestim, takim me persona të rëndësishëm, fatkeqësi natyrore, shkatërrime nga dora e njeriut ose vdekje e personave të rëndësishëm. Lista e ngjarjeve të tilla është shumë e gjatë.

Diskutimi duhet të jetë i gjallë dhe nuk duhet të zgjasë më shumë se 10 minuta. Tërhiqni të gjithë pjesëmarrësit në diskutim dhe kujdesuni që të mos jetë i mërzitshëm, duke ndërhyrë dhe duke i ndihmuar në evokimin e ngjarjeve që ndoshta për moshën që kanë, nuk i kujtojnë.

Kur e kuptoni se interesi i pjesëmarrësve bie, mbylleni brainstormingun dhe tërhiqni vëmendjen e pjesëmarrësve në listën e ngjarjeve që janë trajtuar. Gjatë diskutimit të përgjithshëm pyetini pjesëmarrësit nëse këto ngjarje mund të kenë patur ndikim në jetën e fëmijës së fotografisë, si më poshtë:

- Cilat nga faktet e përmendura mund të ketë ndikim pozitiv, negativ ose asnjë në jetën e fëmijëve që punojnë? Në ç'mënyrë?
- Çfarë është duke bërë tani, pas tre vjetësh, fëmija i fotografisë?
- Në këta tre vjet, a ka ndryshuar në një farë mënyre jeta e fëmijës?
- A është gjallë fëmija?
- Vazhdon të punojë?
- Luan me shokët e vet apo është në gjirin e familjes?

Nxisni shkëmbimin e mendimeve për këto pyetje dhe, nëse është e nevojshme, ndihmoheni zhvillimin e diskutimit. Gjatë zhvillimit të kësaj veprimtarie, të rinjtë dora-dorës do të ndërgjegjësohen për situatën e rëndë dhe dëshpëruese në të cilën ndodhen fëmijët që punojnë, dhe shumë pak, nga faktet dhe ngjarjet që ndodhin në botë, i ndihmojnë ata të ndryshojnë fatin e tyre të mjerë. Ata lodhen, punojnë pa pushim dhe përpiqen të kenë një të ardhme më të mirë, por kjo shpresë shpesh ndërpritet kur ata janë ende fëmijë. Në këtë pikë të zhvillimit të veprimtarisë, të rinjtë duhet të kenë kuptuar se është e nevojshme të ndryshojë diçka për këta fëmijë.

Kur e kuptoni se veprimtaria e ka realizuar qëllimin e saj, kaloni në veprimtarinë e mëpasme.



Lufta për ndryshim



Kjo është veprimtaria përfundimtare e modulit. Edhe kjo duhet të zhvillohet në formën e brainstormingut. Qëllimi është t'i bëjë të rinjtë të mendojnë dhe të përcaktojnë ato ngjarje dhe veprime që mund të sjellin ndryshime dhe të përmirësojnë jetën e fëmijëve që punojnë, veçanërisht të fëmijës që paraqitet në fotografinë e tyre.

Bëni këto pyetje:


- Çfarë mund të bëjmë për të ndryshuar jetën e fëmijëve që punojnë?
- A mund të bëjnë diçka të rinjtë e grupit për të ndryshuar jetën e fëmijëve që lypin në rrugë apo që lajnë xhamat e makinave në semaforë?
- Si ndodh në të vërtetë ndryshimi në botë?
- Si ndodh ndryshimi tek pjesëtarët e grupit?
- A është i rëndësishëm ndryshimi dhe pse?

Ashtu siç keni vepruar më parë, nxisni për 5-10 minuta shkëmbimin e mendimeve, por këtë radhë vetë ju duhet të shkruani në dërrasën e zezë idetë dhe mendimet që dalin. Bëni kujdes që diskutim të zhvillohet me ritëm dhe të mos ketë pauza. Duke u dhënë kohë të gjatë për të menduar përgjigjen, të rinjtë mund të ngurojnë të shprehen, duke menduar se ajo që do të thonë, mund të mos jetë interesante. Kini parasysh se në seancat e brainstormingut, ideja dhe mendimet e para janë shumë të rëndësishme për të zhvilluar diskutimin.

Kur jeni të sigurtë se vëmendja ka humbur, mbylleni diskutimin, përmbliidhni shkurtimisht idetë që kanë dalë, dhe kërkoni një përcaktim të fundit për to nga pjesëmarrësit.

Ç'duhet bërë dhe ç'duhet mënjanuar

- Jepuni pjesëmarrësve kohën e duhur për të skicuar profilin e fëmijës që punon. Ndonjëri do të bëjë shaka dhe ndoshta ironia e tij mund të pengojë zhvillimin e veprimtarisë në grupin ku bën pjesë. Të rinjtë e grupet që punojnë me seriozitet, do të ndikojnë edhe në punën e grupeve të tjera.
- Mundohuni t'u shkëputeni modeleve të gatshme në përcaktimin e fëmijëve që punojnë, si dhe në krijimin e grupeve në klasë. P.sh., mos krijoni grupe të veçanta për vajza dhe për djem, duke u dhënë djemve fotografi që paraqesin punë tipike për djemtë dhe vajzave fotografi që tregojnë punë tipike për vajzat. Kjo gjë është e gabuar. Grupet krijohen me vajza dhe djem dhe gjeni fotografi që tregojnë se dhe vajzat bëjnë punë të rënda fizike ose dhe djemtë përdoren për prostitutum.
- Kini kujdes, nuk duhet të bëni shumë pyetje. Jepuni mundësi dhe kohë të rinjve të bëjnë vetë pyetje. Ata mund të kenë ide origjinale. Kjo ka rëndësi të veçantë, pasi është tregues i interesit dhe shkallës së përfshirjes së tyre në këtë veprimtari.
- Nxisni pjesëmarrjen aktive të të rinjve në këtë veprimtari.
- Në seancat e brainstormingut, nxisni pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në diskutim. Klima e diskutimit duhet të jetë sa më e këndshme dhe argëtuese. Duhet patur parasysh se tema që trajtohet nga pikëpamja emocionale dhe psikologjike, është "e rëndë" për të rinjtë, prandaj është e nevojshme krijimi i një mjedisi të ngrohtë.
- Gjatë seancave të brainstormingut, bëni kujdes të ruani një ritëm të gjallë, pa zvarritje. Suksesi i brainstormingut qëndron në faktin se pjesëmarrësit shprehin mendimin menjëherë, nën presion. Pyetjet bëjini njëra pas tjetrës dhe lëvizni nëpër klasë. Përfshini në diskutim të gjithë të rinjtë dhe bëjuni pyetje të drejtpërdrejta atyre që rrinë të mënjanuar.



- Mos lejoni që brainstormingu të degjenerojë, kjo veprimtari duhet të jetë e këndshme dhe argetuese, por pa mënjanuar karakterin serioz dhe rëndësinë që ka problemi i punës së fëmijëve. Mbani situatën nën kontroll.
- Mos e zgjasni shumë seancën e brainstormingut, pasi ngarkesa me të cilën zhvillohet, i lodh pjesëmarrësi dhe ata mund të mos ju ndjekin.
- Kontrolloni ritmin me të cilën zhvillohet puna në grup. Sigurohuni që të gjithë të marrin pjesë dhe të ndihmojnë me mendimet e tyre.
- Seancat përfundimtare përdorini me frytshmëri dhe krijoni mundësinë që pjesëmarrësit të shprehen lirshëm.

Diskutimi përfundimtar

1 orë mësimi



Nëse vendosni që diskutimin ta bëni pas ushtrimit të *brainstormingut*, përdoreni këtë kohë edhe si çlodhje, gjatë së cilës pjesëmarrësit rimarrin energjitë e humbura. Filloni bisedën duke i lënë të lirë të trajtojnë çfarëdolloj teme edhe pse nuk ka lidhje me punën e fëmijëve. Do të vëreni se puna e fëmijëve do të jetë tema mbizotëruese e diskutimit.

Pas kësaj hyrjeje, kur e ndjeni që ritmi i ushtrimit të *brainstormingut* ka rënë, filloni të zhvilloni një diskutim më serioz rreth asaj si mund të realizosh ndryshime në lidhje me punën e fëmijëve. Shpjegoni që ndryshimi vjen si rrjedhojë e dëshirës dhe pjesëmarrjes së projektit SCREAM – Ndal punës së fëmijëve, njerëzve të veçantë, grupeve shoqërore dhe përfaqësuesve të komuniteteve. Kjo dëshirë zhvillohet më tej në veprime konkrete, madje dhe në realizimin e ndryshimeve.

Ndryshimet ndodhin kur shumë njerëz i kërkojnë ato dhe për këtë ju drejtohen me këmbëngulje kryetarëve të komuniteteve, politikanëve, qeverive, enteve lokale, si dhe organizmave ndërkombëtarë. Ndryshimi realizohet kur

sigurohet ndihma dhe mbështetja e komunitetit dhe e organizatave shoqërore, sindikatave, organizatave humanitare etj. Ndryshimi kërkon kohë, motivim, pjesëmarrje dhe dëshirë për të vepruar.

Të gjitha ndryshimet shoqërore fillojnë nga një forcë shoqërore. Kjo forcë shoqërore mund të jenë të rinjtë, historia ka dëshmuar se të rinjtë janë një forcë aktive dhe e fuqishme. Në lidhje me punën e fëmijëve janë ngritur disa organizma, të cilat marrin parasysh ndihmën që duhet të japin të rinjtë në të gjithë botën. Ndhimesa e tyre është po aq e rëndësishme, sa dhe ndihmesa e shtresave të tjera të shoqërisë, madje edhe më e madhe, pasi këta janë bashkëmoshatarët e fëmijëve që duhet të ndihmojnë.

Vlerësimi dhe vazhdimi

Krahas përfundimeve të veçanta të modulit, ka edhe tregues emocionalë dhe psikologjikë që do t'ju ndihmojnë të vlerësoni ndikimin e modulit.

Përfundimi i matshëm i veprimtarisë së parë është krijimi i figurës së fëmijës që punon. Secili grup duhet të përshkruajë profilin e fëmijës që është paraqitur në fotografi. Objektivat e këtij moduli mund të quhen të arritura, nëse secili grup ka dhënë një profil të detajuar dhe të thelluar të fëmijës që punon. Kjo të jep të kuptosh se deri në çfarë mase kanë perceptuar ata fëmijën që punon. Sa më hollësisht të jepet profili i fëmijës, sa më krijues dhe me fantazi të jetë përshkrimi, aq më shumë tregohet se të rinjtë e kanë pëlqyer këtë lloj ushtrimi dhe, për rrjedhojë, edhe figurën e fëmijës që kanë përshkruar.

Në veprimtarinë 2 nuk ka fare tregues të veçantë për të vlerësuar. Treguesi kryesor që mund të zbulojë ndikimin që ka patur moduli, është pjesëmarrja në diskutim dhe veçanërisht në seancat e brainstormingut. Duhet t'ju ketë rënë në sy që shumë herë gjatë zhvillimit të modulit, u drejtohemi aftësive të pjesëmarrësve për të skicuar profilin e fëmijës që punon. Të gjitha këto elemente shprehin, në një farë mënyre, ndikimin që ka zhvillimi i modulit tek pjesëmarrësi.



Ky modul është urëlidhës ndërmjet veprimtarive sensibilizuese për punën e fëmijëve dhe përshkrimit të figurës së fëmijës që punon. Moduli është ndërtuar në mënyrë të tillë që shkallë-shkallë të zhvillojë ndërgjegjësim për praninë e problemit të punës së fëmijëve, për faktin që kjo dukuri godet fëmijët e vegjël që, si të gjithë njerëzit, përjetojnë dhimbjen, shfrytëzimin dhe ndjenja të tjera. Përfundimi mund të jetë shumë i fuqishëm dhe të ketë një ndikim të fortë tek të rinjtë. Në shumë vende, dhunimi i të drejtave të njeriut përjetohej si dukuri që u takon vendeve, shoqërive apo dhe rajoneve të tjera të botës. Por, nëse dëshirojmë, mund të lëmë mënjanë atë që ndodh në vende të tjera të botës. Ky modul duhet të sjellë një ndryshim në mënyrën si të rinjtë perceptojnë punën e fëmijëve. Tashmë ky problem ka një pamje konkrete dhe vetë të rinjtë japin ndihmë për ta përvijuar këtë gjatë zhvillimit të modulit.

Ndoshta ata janë tashmë të gatshëm t'i bashkëngjiten IPEC-ut, pasi ata kanë zhvilluar një ndjenjë të fortë ndaj figurës së fëmijës që punon. Atë çka kanë krijuar gjatë zhvillimit të modulit, është një imazh i pasqyruar në një person konkret, që shumë mirë mund të jetë dhe anëtar i grupit të tyre.

Pasi të keni përfunduar këtë modul, jini gati të kaloni në modulin e mëpasshëm. Ju ftojme të vazhdoni me një modul që mbështetet në figurën e fëmijës që punon, tashmë të krijuar dhe që pjesëmarrësit e kanë për zëmër. Kështu, në modulin "Loja me role", të rinjtë mund t'u japin jetë personazheve që kanë krijuar, duke interpretuar momente të caktuara të jetës së këtyre fëmijëve.